



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1951/ 10 prot.

Datë 09.12.2022

V E N D I M
Nr. 1222/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.12.2022 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi operatorit ekonomik BOE “Clover” SHPK & “Vuho 2018” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*” me Nr. REF-33139-06-16-2022, me objekt “*Blerje kablllo fuqie TM/TU dhe aksesore ndihmës*”, me fond limit 149,936,016 lekë pa TVSH, ose 1,251,030 euro pa TVSH sipas kursit të datës 16.06.2022 të Bankës Shqiptare, zhvilluar në datën 12.08.2022 nga autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH Fier.

Ankimues: Operatori ekonomik “Aci Engineering” SHPK
Adresa: Rr “Siri Kodra”, Blloku i Magazinave, Kati i dyte.
Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria Rajonale e OSSH Fier.
Adresa: Rruga “Enriko Veizi”, Lagjia “1 Maj”, Fier.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e*

Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.06.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-33139-06-16-2022, me objekt “Blerje kablllo fuqie TM/TU dhe aksesore ndihmës”, me fond limit 149,936,016 lekë pa TVSH, ose 1,251,030 euro pa TVSH sipas kursit të datës 16.06.2022 të Bankës Shqiptare, zhvilluar në datën 12.08.2022 nga autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH Fier.

II.2. Në datë 12.08.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit prokurimeve elektronike rezulton, se në datën 31.08.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë

pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “Clover” SHPK & “Vuho 2018” SHPK	118.215.000 leke	kualifikuar
2. “Aci Engineering” SHPK	127.462.000 leke	kualifikuar
3. “Start CO” SHPK	138.625.500 leke	skualifikuar

II.4. Në datën 01.09.2022 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku për këtë procedurë prokurimi është shpallur fituese oferta e BOE “*Clover*” SHPK & “*Vuho 2018*” SHPK

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 09.09.2022, operatori ekonomik ankimues “*Aci Engineering*” SHPK, ka paraqitur ankesë nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor nr. 1951/2022 protokolli, datë 09.09.2022 dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2530 nëpërmjetë së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “*Clover*” SHPK & “*Vuho 2018*” SHPK.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 dhe 4/c të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1951/2 prot., datë 12.09.2022, u publikuan kriteret e kualifikimit të cilat operatori ekonomik ankimues “*Aci Engineering*” SHPK pretendon, se nuk përmbushen nga bashkimi i operatorit ekonomik “*Clover*” SHPK & “*Vuho 2018*” SHPK.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se më datë 19.09.2022 me shkresën nr. 1951/3, pranë Komisionit Prokurimit Publik është depozituar formulari i paraqitjes së argumenteve nga bashkimi operatorëve ekonomikë “*Clover*” SHPK & “*Vuho 2018*” SHPK, sipas parashikimeve në nenin 113 ligji Nr.162/2020 për prokurimin publik.

II.8. Me shkresën nr. 496/1 prot., datën 19.09.2022, protokolluar me tonën me nr. 1951/4 prot., datë 21.09.2022, me objekt “*Kthim përgjigje*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor, si dhe vendimi nr. 283/32 prot, datë 19.09.2022 lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*Aci Engineering*” SHPK, në të cilën konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ka vendosur mos pranimin e ankesës me përmbajtje si më poshtë vijon:

Operatori ekonomike “Aci Engineering” shpk ne ankesen e tij pretendon se KVO ka kualifikuar shoqerine “Clover” shpk pa te drejte pasi nuk i plotëson kerkesat teknike për

mostrat e paraqitura ditën e hapjes së ofertave. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pasi mori në shqyrtim gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Njësia e prokurimit për procedurën në fjalë vlerëson se:

- Në dokumentat e tenderit të shpallur në sistemin e APP-së nga ana e Autoritetit kontraktor Dr. Rajonale Fier Ossh sha Fier, është kërkuar të paraqiten mostra ditën e hapjes së ofertave perkatesisht:
- Muftë TU 0,4 KV per kabell 4x25-150 mm²
- Muftë TM per kabell te thate 24 KV 1x(95-240) mm²
- Kabell TU, AL 4x 95 mm², XLPE, 0.6/1kV
- Kabell TM 10 kV, XLPE, Al - 3x 95mm²

Në momentin e hapjes së ofertave operatorët pjesëmarrës kanë paraqitur mostrat përkatëse. Ashatu sic pasqyrohet dhe ne procesverbalin për marijen në dorëzim të mostrave date 12.08.2022 operoret ekonomik kane dorëzuar mostrat si më poshtë:

“Start Co” shpk ka dorëzuar mostrat si mëposhte per vleresim:

- Muftë TU 0,4 KV per kabell 4 x 25-150 mm² (mungojne gilzat)
- Muftë TM per kabell te thate 24 KV 1 x (95-240) mm²
- Kabell TU, AL 4 x 95 mm², XLPE, 0.6/1kV
- Kabell TM (i pa specifikuar lloji i kabullit)

“Clover ” shpk ka dorëzuar mostrat si mëposhte:

- Muftë TU 0,4 KV per kabell 4 x 25-150 mm² (gilza 95/240)
- Muftë TM per kabell te thate 24 KV 1 x (95-240) mm²
- Kabell TU, AL 4 x 95 mm², XLPE, 0 6/1 kV
- Kabell TM 10 kV, XLPE, Al – 3 x 95 mm²

“ACI Engineering ” shpk ka dorëzuar mostrat si mëposhte :

- Muftë TU 0,4 KV per kabell 4 x 25-150 mm² (gilza TU 50/150)
- Muftë TM per kabell te thate 24 KV 1 x (95-240) mm²
- Kabell TU, AL 4 x 95 mm², XLPE, 0.6/1kV
- Kabell TM 10 kV, XLPE, Al – 3 x 95mm²

“AA&P ” shpk ka dorëzuar mostrat si mëposhte per vleresim:

- Muftë TU 0,4 KV per kabell 4 x 25-150 mm² (gilza 35/150)
- Muftë TM per kabell te thate 24 KV 1 x (95-240) mm²
- Kabell TU, AL 4 x 95 mm², XLPE, 0.6/1kV

- *Kabell TM 10 kV, XLPE, Al – 3 x 95 mm²*

Nga sa është paraqitur më sipër duke u bazuar në pretendimin e Ankimuesit se gilza e paraqitur nga OE “Clover” shpk nuk i permbush kërkesat teknike për mostrën nr. 1 të kërkuar në DST, sipas këtij pretendimi të ankimuesit nga sa vërehet dhe më sipër asnjë prej operatorëve ekonomik që kanë paraqitur mostra nuk i permbushin parametrat e pretenduara nga Ankimuesi.

Po ashtu dhe ofertuesi “AA&P” shpk ka paraqitur gilza 35/150 e cila nuk përfshin kabujt me seksion 4 x 25

Komisioni i shqyrtimit të ankesës pasi shqyrtoi dhe specifikimet teknike për mallrat objekt prokurimi vëren se në specifikimet teknike nuk janë të përcaktuara dimensionet e gilzave, për këtë arsye cdo operatorë ka sjellë dimensione të ndryshme për gilza.

Nga sa vërehet Komisioni i vlerësimit të ofertave ka vlerësuar për aq sa kërkohet në dokumentat e tenderit ku për mostra nuk është kërkuar specifikisht paraqitja e gilzave për vlerësim, për këtë arsye dhe nuk janë marrë parasysh dimensionet e gilzave.

Për sa i përket pretendimit të Ankimuesit për mungesën e Test Raporteve për mallra objekt prokurimi të shoqërisë “Clover” shpk, në bazë të verifikimit të dokumentacionit të paraqitur online në sitemin e APP-së rezulton se test raportet e pretenduara në ankesë janë ngarkuar online në sistem nga shoqëria “Clover” shpk.

Sa më sipër vlerësojmë se pretendimet e Ankimuesit “ACI Engineering” shpk nuk qëndrojnë për këtë arsye ankesa nuk merret parasysh.

Komisioni i shqyrtimit të ankesës sygjeron Autoritetin Kontraktor përpara lidhjes së kontratës të përcaktojë përmasat e gilzave, për të shmangur paqartësitë në zbatimin e kontratës.

II.9. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 1951/5 prot., datë 04.10.2022, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik ankimues.

II.10. Me shkresën nr. 496/3 prot., datën 07.10.2022, protokolluar me tonën me nr. 1951/6 prot., datë 10.10.2022, me objekt “Dërgim informacioni sipas shkresës nr. 1951/5 prot, datë 04.10.2022 të Komisionit Prokurimit Publik”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i detajuar i autoritetit kontraktor në lidhje me procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.11. Me shkresën nr. 1951/7 prot, datë 21.10.2022, me objekt: “Kërkesë për informacion”, Komisioni Prokurimit Publik ka vënë në dijeni autoritetin kontraktor dhe i është drejtuar bashkimit operatorëve ekonomik “Clover” SHPK & “Vuho 2018” SHPK, duke i kërkuar informacion me përmbajtje si vijon:

Në kuadër të shqyrtimit të ankesës së mësipërme, KPP shfaq vështirësi në evidentimin dhe verifikimin e artikujve 1-2-3-4-5-6-7-8-9-10-11-12-13-14 në test raportet e dorëzuara nga ana juaj në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), (për të cilat operatori ekonomik ankimues “Aci Engineering” SHPK pretendon se nuk janë paraqitur nga ana juaj test raporte për këto artikuj).

Konkretisht, Komisioni shfaq vështirësi në evidentimin dhe verifikimin për artikujt nga 1-2-3-4-5-6-7-8-9-10-11-12-13-14 pjesë e dokumentave të tenderit, në test raportet e dorëzuara nga ana juaj në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), për procedurën e mësipërme të prokurimit si më poshtë:

- 1. Muftë TU 0,4 KV per kabell 4x25-95 mm²**
- 2. Muftë TU 0,4 KV per kabell 4x25-150 mm²**
- 3. Muftë TM per kabell te thate 12KV 3 x(70-150) mm²**
- 4. Muftë TM per kabell te thate 24 KV 1x(25-70) mm²**
- 5. Muftë TM per kabell te thate 24 KV 1x(95-240) mm²**
- 6. Gliza me bullon per kabell XLPE - AL 185 mm² 24 kv**
- 7. Muftë TM per kabell me vaj 24 kV 1x(150-240) mm²**
- 8. Muftë TM kalimtare nga kabell I thate XLPE ne kabell me vaj 24 kV 1x (150-240)mm²**
- 9. Koka kablli TM 10kV, te brendshme 3x(25-95)mm²**
- 10. Koka kablli TM 10kV, te brendshme 3x(95-240)mm²**
- 11. Koka kablli TM 20kV, te brendshme 1x(95-240)mm²**
- 12. Koka kablli TM 10kV, te jashtme 1x(25-95)mm²**
- 13. Koka kablli TM 10kV, te jashtme 3x(25-95)mm²**
- 14. Koka kablli TM 20kV, te jashtme 1x(95-240)mm²**

Referuar sa më sipër, me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur dhe shqyrtimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, kërkojmë nga ana juaj të dorëzoni pranë KPP-së informacionin dhe fakte se në cilin test rraport (faqe, paragraf etj.), nga ato të dorëzuar nga ana juaj në Sistemin e Prokurimit Elektronik, gjenden artikujt e sipërcituar.

Përsa më sipër kërkojmë nga ana juaj të dorëzoni pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacionin e kërkuar, brenda ditës së nesërme të punës, nga marrja dijeni e kësaj shkrese.

II.12. Me shkresën nr. 594/1 prot., datë 27.10.2022, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1951/8 prot, datë 31.10.2022 me objekt: “Kthim përgjigje tuajës me prot 1951/7 prot, datë 21.10.2022” autoriteti kontraktor ka dërguar informacion pranë Komisionit Prokurimit

Publik, në lidhje me objektin e kërkesës nr. 1951/7 prot, datë 21.10.2022 me përmbajtje si më poshtë vijonë:

Në vijim të shkresës suaj nr. 1951/7 Prot datë 21.10.2022, protokolluar me tonën me nr. 594 prot datë 24.10.2022 në lidhje me kërkesën për informacion për procedurën e prokurimit: Ref – 33139 – 06 – 16 - 2022 “Blerje kablllo fuqie TM/TU dhe aksesorë ndihmës” për evidentimin e test raporteve për mallrat objekt prokurimi ju bëjmë me dije si më poshtë:

Në bazë të vlerësimit të bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor Drejtoria Rajonale Fier Ossh sha, për vlerësimin e kriterëve të DST-së KVO ka evidentuar Test-Raportet për mallrat objekt prokurimi në sistemin elektronik të APP- së:

- *Artikulli numer 1 i emertuar “Mufte TU 0,4 KV per kabell 4 x 25-95 mm²” perfaqesohet me test raportin numer C0001314, faqe numer 1 deri ne faqen numer 6 te dokumentit te ngarkuar elektronikisht ne sistemin e APP-se te emertuar “test raporte elcon megarad.pdf”.*
- *Artikulli numer 2 i emertuar “Mufte TU 0,4 KV per kabell 4 x 25-150 mm²” perfaqesohet me test raportin numer C0001314, faqe numer 1 deri ne faqen numer 6 te dokumentit te ngarkuar elektronikisht ne sistemin e APP-se te emertuar “test raporte elcon megarad.pdf”.*
- *Artikulli numer 3 i emertuar “Mufte TM per kabell te thate 12 KV 3 x (70-150) mm²” perfaqesohet me test raportin numer 477_15, faqe numer 48 deri ne faqen numer 69 te dokumentit te ngarkuar elektronikisht ne sistemin e APP-se te emertuar “test raporte te tjera elcon megarad.pdf”.*
- *Artikulli numer 4 i emertuar “Mufte TM per kabell te thate 24 KV 1 x (25-70) mm²” perfaqesohet me test raportin numer TT36_21 , faqe numer 68 deri ne faqen numer 73 te dokumentit te ngarkuar elektronikisht ne sistemin e APP-se te emertuar “test raporte elcon megarad.pdf”.*
- *Artikulli numer 5 i emertuar “Mufte TM per kabell te thate 24 KV 1 x (95-240) mm²” perfaqesohet me test raportin numer 438A_14, faqe numer 26 deri ne faqen numer 35 te dokumentit te ngarkuar elektronikisht ne sistemin e APP-se te emertuar “test raporte te tjera elcon megarad.pdf”.*
- *Artikulli numer 6 i emertuar “Gilza me bullon per kabell XLPE - AL 185 mm² 24 kv” perfaqesohet me test raportin numer 2007-154 , faqe numer 53 deri ne faqen numer 67 te dokumentit te ngarkuar elektronikisht ne sistemin e APP-se te emertuar “test raporte elcon megarad.pdf”*
- *Artikulli numer 7 i emertuar “Mufte TM per kabell me vaj 24 kV 1 x (150-240) mm²” perfaqesohet me test raportin numer 477_15, faqe numer 48 deri ne faqen numer 69 te dokumentit te ngarkuar elektronikisht ne sistemin e APP-se te emertuar “test raporte te tjera elcon megarad.pdf”*
- *Artikulli numer 8 i emertuar “Mufte TM kalimtare nga kabell i thate XLPE ne kabell me vaj 24 kV 1 x (150-240)mm²” perfaqesohet me test raportin numer 4748/VNL, faqe numer 37 deri ne faqen numer 52 te dokumentit te ngarkuar elektronikisht ne sistemin e APP-se te emertuar “test raporte elcon megarad.pdf”.*

- Artikulli numer 9 i emertuar “Koka kablli TM 10 kV, te brendshme 3 x (25- 95) mm2” perfaqesohet me test raportin numer 477_15, faqe numer 48 deri ne faqen numer 69 te dokumentit te ngarkuar elektronikisht ne sistemin e APP-se te emertuar “test raporte te tjera elcon megarad.pdf”.
- Artikulli numer 10 i emertuar “Koka kablli TM 10 kV, te brendshme 3 x (95- 240) mm2” perfaqesohet me test raportin numer 439_15, faqe numer 36 deri ne faqen numer 47 te dokumentit te ngarkuar elektronikisht ne sistemin e APP-se te emertuar “test raporte te tjera elcon megarad.pdf”.
- Artikulli numer 11 i emertuar “Koka kablli TM 20 kV, te brendshme 1 x (95- 240) mm2” perfaqesohet me test raportin numer 439_15, faqe numer 36 deri ne faqen numer 47 te dokumentit te ngarkuar elektronikisht ne sistemin e APP-se te emertuar “test raporte te tjera elcon megarad.pdf”.
- Artikulli numer 12 i emertuar “Koka kablli TM 10 kV, te jashtme 1 x (25-95) mm2” perfaqesohet me test raportin numer KEMA 98471405-HVL 99-1218, faqe numer 1 deri ne faqen numer 25 te dokumentit te ngarkuar elektornikisht ne sistemin e APP-se te emertuar “test raporte te tjera elcon megarad.pdf”.
- Artikulli numer 13 i emertuar “Koka kablli TM 10 kV, te jashtme 3 x (25-95) mm2” perfaqesohet me test raportin numer 477_15, faqe numer 48 deri ne faqen numer 69 te dokumentit te ngarkuar elektronikisht ne sistemin e APP-se te emertuar “test raporte te tjera elcon megarad.pdf”.
- Artikulli numer 14 i emertuar “Koka kablli TM 20 kV, te jashtme 1 x (95- 240) mm2” perfaqesohet me test raportin numer EËP/68/E/2006/2007-1-e, faqe numer 7 deri ne faqen numer 36 te dokumentit te ngarkuar elektronikisht ne sistemin e APP-se te emertuar “test raporte elcon megarad.pdf”.

II.13. Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e bashkimit të operatorit ekonomikë “Clover” SHPK & “Vuho 2018” SHPK në mbështetje të nenit 115 pika 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me shkresën nr.1291/14 prot. datë 21.10.2022 me lëndë “Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, KPP ka njoftuar autoritetin kontraktor dhe bashkimin e operatorit ekonomikë “Clover” SHPK & “Vuho 2018” SHPK për zhvillimin e një seance dëgjimore në datë 25.11.2022, ora 11:00 në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik.

II.14. Në datën 25.11.2022, ora 11:00 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, u mbajt Seanca Dëgjimore midis përfaqësuesit z. A. M të bashkimit të operatorit ekonomikë “Clover” SHPK & “Vuho 2018” SHPK, dhe përfaqësuesit të autoritetit kontraktor z. A. N dhe anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik. Në seancën dëgjimore, Komisioni drejtoi pyetje inxhinierit të autoritetit kontraktor dhe përfaqësuesit të bashkimit të operatorit ekonomikë “Clover” SHPK & “Vuho 2018” SHPK, me qëllim shqyrtimin e pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues dhe verifikimin e specifikimeve teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor. Gjatë seancës, u mbajt Procesverbali datë 25.11.2022, i cili u nënshkrua nga të gjitha palët pjesëmarrëse në seancë me përmbajtje ndër të tjera si më poshtë vijon:

1. Ju lutem sqaroni se ne cilin test raport te paraqitur ne SPE gjenden te pershkruar artikulli nr 1 Mufte TU 0,4 KV per kabell 4x25-95 mm² dhe artikulli nr. 2 Mufte TU 0,4 KV per kabell 4x25-150 mm².

Nga ana e përfaqesuesit te OE u citua se ky artikull gjendet ne test raportin nr C0001314 konkretisht ne faqen 3 gjenden test raportet e këtyre artikujve dhe konkretisht tek pershkrimi ato identifikohen me kodet FN 19854 dhe FN 19890, edhe perfaqesuesi i autoritetit kontraktor pohoi se artikujt e mesiperme perfaqesohen me test raportin numer C0001314, faqe numer 1 deri ne faqen numer 6 te dokumentit te ngarkuar elektornikisht ne sistemin e APP-se te emertuar "test raporte elcon megarad.pdf"; të dy palët në lidhje me specifiken per kabell 4x25-95 mm², ata u shprehen se ne kete kode produkti yne eshte i permbushr me 2x25/16 2x25 pra ky product ka ne perberje te tij 4 fije me seksion 25 mmm , ndersa ne lidhje me dimesionin e seksionit ata citojne se teste raportet e dorzuara nga ana jone e perfshin dhe seksionin e kerkuar nga AK pasi jane per nje seksion me te madh.

2. Ju lutem sqaroni se ne cilin test raport te paraqitur ne SPE gjenden te pershkruar artikulli nr 3 Mufte TM per kabell te thate 12KV 3 x(70-150) mm².

Nga ana e përfaqesuesit te OE u citua se ky artikull gjendet ne test raportin nr 447_15 konkretisht ne faqen 2 gjendet test raporti i këtij artikulli dhe konkretisht tek pershkrimi ai identifikohet nga kodi mr nr rendor 3 deri ne kodin me nr rendor 6 te faqes 2 ne te cilat identifikohet numri i dejeve 3, edhe perfaqesuesi i autoritetit kontraktor pohoi se artikulli i mesiperme perfaqesohen me test raportin numer 447_15, faqe numer 48 deri ne faqen numer 69 te dokumentit te ngarkuar elektornikisht ne sistemin e APP-se te emertuar "test raporte te tjera elcon megarad.pdf"; të dy palët në lidhje me specifiken per kabell 12 kv 3x70-150 mm², ata u shprehen se test raporti kryhet per nje pjese te kabullit pasi si kabulli me tre deje ashtu dhe ai me nje deje i njejti testim i kryhet gjithashtu dhe perberja e tyre eshte e njejte thjeshte ndryshon sasia e kabullit, ndersa ne lidhje me dimesionin e seksionit ata citojne se teste raportet e dorzuara nga ana jone e perfshin dhe seksionin e kerkuar nga AK pasi jane per nje seksion me te madh.

3. Ju lutem sqaroni se ne cilin test raport te paraqitur ne SPE gjenden te pershkruar artikulli nr 4 Mufte TM per kabell te thate 24 KV 1x(25-70) mm².

Nga ana e përfaqesuesit te OE u citua se ky artikull gjendet ne test raportin nr TT36_21 konkretisht ne faqen 2 gjendet test raporti i këtij artikulli dhe konkretisht tek pershkrimi ai identifikohet me kodin ELCOTERM GLC-2463 E U/U tension 15/8,7 kv, seksion 3x50 mm Cu / 3x70 mm Al edhe perfaqesuesi i autoritetit kontraktor pohoi se artikulli i mesiperme perfaqesohen me test raportin numer TT36 21 , faqe numer 68 deri ne faqen numer 73 te dokumentit te ngarkuar elektronikisht ne sistemin e APP-se te emertuar "test raporte elcon megarad.pdf"; të dy palët në lidhje me specifiken per kabell 24 KV 1x(25-70) mm², ata u shprehen se test raporti ne lidhje me dimesionin e seksionit ata citojne se teste raportet e dorzuara nga ana jone e perfshin dhe seksionin e kerkuar nga AK pasi jane per nje seksion

me te madh. Ne lidhje me tensionin e kerkuar 24 kv dhe ne test raport percaktohet 15/8,7 kv, shprehen se test raporti yne eshte kryer me tension me te larte nga 34.8 deri 110 kv.

4. Ju lutem sqaroni se ne cilin test raport te paraqitur ne SPE gjenden te pershkruar artikulli nr 5 Mufte TM per kabell te thate 24 KV 1x(95-240) mm2.

Nga ana e përfaqesuesit te OE u citua se ky artikull gjendet ne test raportin nr 438A_14 konkretisht ne faqen 2 gjendet test raporti i këtij artikulli dhe konkretisht tek pershkrimi ai identifikohet me kodin ELCOTERM GLS-4285/ALë-R tension 20.8, / 36 kv, seksion 1x240 sqmm AL/XLPE/PVC IEC 60502-4 edhe perfaqesuesi i autoritetit kontraktor pohoi se artikulli i mesiperme perfaqesohen me test raportin numer 438A_14, faqe numer 26 deri ne faqen numer 35 te dokumentit te ngarkuar elektornikisht ne sistemin e APP-se te emertuar “test raporte te tjera elcon megarad.pdf”; të dy palët në lidhje me specifikën per kabell 24 KV 1x(95-240) mm2, ata u shprehen se test raporti ne lidhje me dimesionin e seksionit ata citojne se teste raportet e dorzuara nga ana jone e perfshin dhe seksionin e kerkuar nga AK pasi jane per nje seksion me te madh. Ne lidhje me tensionin e kerkuar 24 kv dhe ne test raport percaktohet 20.8/36 kv, shprehen se test raporti yne eshte kryer me tension me te larte max 42 kv.

5. Ju lutem sqaroni se ne cilin test raport te paraqitur ne SPE gjenden te pershkruar artikulli nr 7 Mufte TM per kabell me vaj 24 kV 1x(150-240) mm2.

Nga ana e përfaqesuesit te OE u citua se ky artikull gjendet ne test raportin nr 447_15 konkretisht ne faqen 2 gjendet test raporti i këtij artikulli dhe konkretisht tek pershkrimi ai identifikohet me kodin ECOLD GLS 3689 1x120 ÷240 sqmm Cu/Al, perfaqesuesi i autoritetit kontraktor pohoi se artikulli i mesiperme perfaqesohen me test raportin numer 477_15, faqe numer 48 deri ne faqen numer 69 te dokumentit te ngarkuar elektronikisht ne sistemin e APP-se te emertuar “test raporte te tjera elcon megarad.pdf”; të dy palët në lidhje me specifikën per kabell 24 kV 1x(150-240) mm2, ata u shprehen se test raporti ne lidhje me dimesionin e seksionit ata citojne se teste raportet e dorzuara nga ana jone e perfshin dhe seksionin e kerkuar nga AK pasi jane per nje seksion me diapazon nga 120 – 240, i cili perfshin dhe 150 si seksion. me te madh. Ne lidhje me tensionin e kerkuar 24 kv dhe ne test raport percaktohet 24 -36 kv, shprehen se test raporti yne eshte kryer me tension me te larte duke perfshire dhe 24 kv e kerkuar.

6. Ju lutem sqaroni se ne cilin test raport te paraqitur ne SPE gjenden te pershkruar artikulli nr 8 Mufte TM kalimtare nga kabell I thate XLPE ne kabell me vaj 24 kV 1x (150-240) mm2.

Nga ana e përfaqesuesit te OE u citua se ky artikull gjendet ne test raportin nr 4748 / VNL konkretisht ne faqen 3 gjendet test raporti i këtij artikulli dhe konkretisht tek pershkrimi ai identifikohet me kodin ELCOTERM GLM 2463/EN konkretisht mufte kalimtare 12.7/22 (24) kv 95-240 mm2, perfaqesuesi i autoritetit kontraktor pohoi se artikulli i mesiperme perfaqesohen me test raportin numer 4748/VNL , faqe numer 37

deri ne faqen numer 52 te dokumentit te ngarkuar elektomikisht ne sistemin e APP-se te emertuar "test raporte elcon megarad.pdf"; të dy palët në lidhje me specifikën per kabell 24 kV 1x(150-240) mm², ata u shprehen se test raporti ne lidhje me dimesionin e seksionit ata citojne se teste raportet e dorzuara nga ana jone e perfshin dhe seksionin e kerkuar nga AK pasi jane per nje seksion me diapazon nga 95 – 240, i cili perfshin dhe 150 si seksion me te madh. Ne lidhje me tensionin e kerkuar 24 kv dhe ne test raport percaktohet nga 12-24 kv, shprehen se test raporti yne eshte kryer me tension me te vogel por deri ne 24 kv sic eshte kerkuar.

7. Ju lutem sqaroni se ne cilin test raport te paraqitur ne SPE gjenden te pershkruar artikulli nr 9 Koka kablli TM 10kV, te brendshme 3x(25-95) mm².

Nga ana e përfaqesuesit te OE u citua se ky artikull gjendet ne test raportin nr 447_15 konkretisht ne faqen 2 gjendet test raporti i këtij artikulli dhe konkretisht tek pershkrimi ai identifikohet me kodin ECOLD TES 2464 P 3x1x95÷240 sq. mm Cu/Al, perfaqesuesi i autoritetit kontraktor pohoi se artikulli i mesiperme perfaqesohen me test raportin numer 477 15, faqe numer 48 deri ne faqen numer 69 te dokumentit te ngarkuar elektornikisht ne sistemin e APP-se te emertuar "test raporte te tjera elcon megarad.pdf"; të dy palët në lidhje me specifikën per Koke kablli TM 10kV, te brendshme 3x(25-95)mm², ata u shprehen se test raporti ne lidhje me dimesionin e seksionit ata citojne se teste raportet e dorzuara nga ana jone e perfshin dhe seksionin e kerkuar nga AK ato fillojne ne test raport nga seksioni 50 mm deri ne 240 mm pra perfshin dhe seksionin e kerkuar nga AK,. Ne lidhje me tensionin e kerkuar 10 kv dhe ne test raport percaktohet nga 12-24 kv, shprehen se test raporti yne eshte kryer me tension me madhe sec eshte kerkuar duke perfshire dhe tensionin e kerkuar.

8. Ju lutem sqaroni se ne cilin test raport te paraqitur ne SPE gjenden te pershkruar artikulli nr 10 Koka kablli TM 10kV, te brendshme 3x(95-240) mm².

Nga ana e përfaqesuesit te OE u citua se ky artikull gjendet ne test raportin nr 439_15 konkretisht ne faqen 2 dhe 3 gjendet test raporti i këtij artikulli dhe konkretisht tek pershkrimi ai identifikohet me kodin ELCOTERM TIS- 1282X/Eë 1x95÷240mm² Cu/Al, perfaqesuesi i autoritetit kontraktor pohoi se artikulli i mesiperme perfaqesohen me test raportin numer 439_15, faqe numer 36 deri ne faqen numer 47 te dokumentit te ngarkuar elektornikisht ne sistemin e APP-se te emertuar "test raporte te tjera elcon megarad.pdf"; të dy palët në lidhje me specifikën per Koke kablli TM 10kV, te brendshme 3x(95-240)mm², ata u shprehen se test raporti ne lidhje me dimesionin e seksionit ata citojne se teste raportet e dorzuara nga ana jone e perfshin dhe seksionin e kerkuar nga AK. Ne lidhje me tensionin e kerkuar 10 kv dhe ne test raport percaktohet nga 6-10-12 kv, shprehen se test raporti yne eshte kryer me tension me madhe sec eshte kerkuar duke perfshire dhe tensionin e kerkuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre,

Arsyeton

III.1. . Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Aci Engineering” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorit ekonomik “Clover” SHPK & “Vuho” SHPK me arsyet: “1. Në DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.2.2.7. Kerkohet: Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, operatoret ekonomike ofertues duhet te paraqesin mostrat e mallrave perkatesisht 1- Mufte TU 0,4 KV per kabell 4 x 25-150 mm²; 2- Mufte TM per kabell te thate 24 KV 1 x (95-240) mm²; 3- Kabell TU, AL 4 x 95 mm², XLPE, 0.6/1kV; 4- Kabell TM 10 kV, XLPE, Al – 3 x 95mm². Në ditën e hapjes së ofertave KVO ka kryer kontrollin e 4 (kater) mostrave të kërkuara dhe sic konfirmon KVO me këtë Proces verbal Nr.Prot. 283/18, datë 12.08.2022 rezulton që shoqëria CLOVER Shpk NUK plotëson kërkesat teknike për mostren Nr.1 - Mufte TU 0.4 kV per kablllo 4 x 25-150 mm² (Gilza 95-240 mm²), dmth shoqëria Clover Shpk ka ofertuar një Mufte që sherben për kabllot 4 x 95-240 mm², ndërkohe që në Tabelen e Materialeve OSSH Fier ka kërkuar Mufte për kablllo 4 x 25-150 mm². E shprehur thjesht janë 4 seksione kablllosh që nuk mbulohen dhe kjo Mufte nuk mund të përdoret, pra NUK është në pajtueshmeri me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara nga OSSH Fier. Dhe midis tyre edhe kabllot me seksione 4 x 50 dhe 4 x 70 mm² që janë më të përdorurat në sistemin e shpërndarjes elektrik (rreth 70% e gjithë rrjetit kabllor të shpërndarjes). Kjo do të thotë që tekniku i OSSH Fier që do shkojë të riparojë difektin në kabllot 4 x 50 mm² dhe 4 x 70 mm² dhe ka këtë tip Mufte me vete për riparim, NUK do jetë në gjëndje ta kryej riparimin dhe fideri do mbetet pa u riparuar si dhe konsumatorët përkatës pa energji elektrike.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2.7 “Kapaciteti Teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, operatoret ekonomike ofertues duhet te paraqesin mostrat e mallrave perkatesisht

- Mufte TU 0,4 KV per kabell 4x25-150 mm²
- Mufte TM per kabell te thate 24 KV 1x(95-240) mm²
- Kabell TU, AL 4x 95 mm², XLPE, 0.6/1kV
- Kabell TM 10 kV, XLPE, Al - 3x 95mm²
- ne momentin e hapjes se ofertave prane Autoritetit Kontraktor Drejtorise Rajonale Fier OSSH sh.a..

III.1.2. Në shtojcën 6 “Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Artikulli	Përshkrimi	Njesia	(Sasia)	Periudha e dorëzimit
	MUFTE, KOKA KABLLI TU dhe TM			
1	Mufte TU 0,4 KV per kabell 4x25-95 mm2	set	450	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
2	Mufte TU 0,4 KV per kabell 4x25-150 mm2	set	450	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
3	Mufte TM per kabell te thate 12KV 3 x(70-150) mm2	set	50	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
4	Mufte TM per kabell te thate 24 KV 1x(25-70) mm2	set	300	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
5	Mufte TM per kabell te thate 24 KV 1x(95-240) mm2	set	2500	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
6	Gliza me bullon per kabell XLPE - AL 185 mm2 24 kv	cope	300	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
7	Mufte TM per kabell me vaj 24 kV 1x(150-240) mm2	set	10	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
8	Mufte TM kalimtare nga kabell I thate XLPE ne kabell me vaj 24 kV 1x (150-240)mm2	set	20	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
9	Koka kablli TM 10kV, te brendshme 3x(25-95)mm2	set	250	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
10	Koka kablli TM 10kV, te brendshme 3x(95-240)mm2	set	60	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
11	Koka kablli TM 20kV, te brendshme 1x(95-240)mm2	cope	1200	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
12	Koka kablli TM 10kV, te jashtme 1x(25-95)mm2	set	150	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
13	Koka kablli TM 10kV, te jashtme 3x(25-95)mm2	set	40	90 dite nga nenshkrimi i kontrates

14	Koka kablli TM 20kV, te jashtme 1x(95-240)mm2	cope	400	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
Kablo fuqie TU dhe TM				
15	Kabell TU, AL 4x50 mm2, XLPE, 0.6/1kV	ml	6000	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
16	Kabell TU, AL 4x70 mm2, XLPE, 0.6/1kV	ml	7000	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
17	Kabell TU, AL 4x 95 mm2, XLPE, 0.6/1kV	ml	8000	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
18	Kabell TU, AL 3x 120+70 mm2 ,XLPE, 0.6/1kV	ml	5000	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
19	Kabell TM 10 kV, XLPE, Al - 3x 70mm2	ml	600	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
20	Kabell TM 10 kV, XLPE, Al - 3x 95mm2	ml	2000	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
21	Kabell TM 10 kV, XLPE, Al - 3x 120mm2	ml	1000	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
22	Kabell TM 20 kV, XLPE, gershet Al 3x(1x185)mm2	ml	550	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
23	Kabell TM 20 kV, XLPE, gershet Al 3x(1x240)mm2	ml	1550	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
24	Kabell TM 20 kV, XLPE, Al - 1x 70mm2	ml	700	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
25	Kabell TM 20 kV, XLPE, Al - 1x 1850mm2	ml	1050	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
26	Kabell TM 20 kV, XLPE, Al - 1x 240mm2	ml	2000	90 dite nga nenshkrimi i kontrates

III.1.3. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor me shkresën nr. 496/1 prot., datën 19.09.2022, protokolluar me tonën me nr. 1951/4 prot., datë 21.09.2022, të depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik si dhe vendimit nr. 283/32 prot, datë 19.09.2022 lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*Aci Engineering*” SHPK, në të cilën konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ka vendosur mos pranimin e ankesës me përmbajtje si më poshtë vijon:

Operatori ekonomike “Aci Engineering” shpk ne ankesen e tij pretendon se KVO ka kualifikuar shoqerine “Clover” shpk pa te drejte pasi nuk i plotëson kerkesat teknike për mostrat e paraqitura ditën e hapjes së ofertave. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pasi mori në shqyrtim gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Njësia e prokurimit për procedurën në fjalë vlerëson se:

- Në dokumentat e tenderit te shpallur në sistemin e APP-së nga ana e Autoritetit kontraktor Dr. Rajonale Fier Ossh sha Fier, është kërkuar të paraqiten mostra ditën e hapjes së ofertave perkatesisht:
- Muftë TU 0,4 KV per kabell 4x25-150 mm²
- Muftë TM per kabell te thate 24 KV 1x(95-240) mm²
- Kabell TU, AL 4x 95 mm², XLPE, 0.6/1kV
- Kabell TM 10 kV, XLPE, Al - 3x 95mm²

Në momentin e hapjes së ofertave operatorët pjesëmarrës kanë paraqitur mostrat përkatëse. Ashatu sic pasqyrohet dhe ne procesverbalin për marijen në dorezim të mostrave date 12.08.2022 operoret ekonomik kane dorëzuar mostrat si më poshtë:

“Start Co” shpk ka dorezuar mostrat si meposhte per vleresim:

- Muftë TU 0,4 KV per kabell 4 x 25-150 mm² (mungojne gilzat)
- Muftë TM per kabell te thate 24 KV 1 x (95-240) mm²
- Kabell TU, AL 4 x 95 mm², XLPE, 0.6/1kV
- Kabell TM (i pa specifikuar lloji i kabullit)

“Clover ” shpk ka dorezuar mostrat si meposhte:

- Muftë TU 0,4 KV per kabell 4 x 25-150 mm² (gilza 95/240)
- Muftë TM per kabell te thate 24 KV 1 x (95-240) mm²
- Kabell TU, AL 4 x 95 mm², XLPE, 0 6/1 kV
- Kabell TM 10 kV, XLPE, Al – 3 x 95 mm²

“ACI Engineering ” shpk ka dorezuar mostrat si meposhte :

- Muftë TU 0,4 KV per kabell 4 x 25-150 mm² (gilza TU 50/150)
- Muftë TM per kabell te thate 24 KV 1 x (95-240) mm²
- Kabell TU, AL 4 x 95 mm², XLPE, 0.6/1kV
- Kabell TM 10 kV, XLPE, Al – 3 x 95mm²

“AA&P ” shpk ka dorëzuar mostrat si meposhte per vleresim:

- Muftë TU 0,4 KV per kabell 4 x 25-150 mm² (gilza 35/150)
- Muftë TM per kabell te thate 24 KV 1 x (95-240) mm²
- Kabell TU, AL 4 x 95 mm², XLPE, 0.6/1kV
- Kabell TM 10 kV, XLPE, Al – 3 x 95 mm²

Nga sa është paraqitur më sipër duke u bazuar në pretendimin e Ankimuesit se gilza e paraqitur nga OE "Clover" shpk nuk i permbush kërkesat teknike për mostrën nr. 1 të kërkuar në DST, sipas këtij pretendimi të ankimuesit nga sa vërehet dhe më sipër asnjë prej operatorëve ekonomik që kanë paraqitur mostra nuk i permbushin parametrat e pretenduara nga Ankimuesi.

Po ashtu dhe ofertuesi "AA&P" shpk ka paraqitur gilza 35/150 e cila nuk përfshin kabujt me seksion 4 x 25

Komisioni i shqyrtimit të ankesës pasi shqyrtoi dhe specifikimet teknike për mallrat objekt prokurimi vëren se në specifikimet teknike nuk janë të përcaktuara dimensionet e gilzave, për këtë arsye çdo operatorë ka sjellë dimensione të ndryshme për gilza.

Nga sa vërehet Komisioni i vlerësimit të ofertave ka vlerësuar për atë sa kërkohet në dokumentat e tenderit ku për mostra nuk është kërkuar specifikisht paraqitja e gilzave për vlerësim, për këtë arsye dhe nuk janë marrë parasysh dimensionet e gilzave.

III.1.4. Referuar nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin Publik" përcaktohet se: "1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet 12 kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të

zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, konkretisht kriterit të vecantë të kualifikimit pikës 2.2.7 në të cilin është përcaktuar se operatorët ekonomik në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin mostrat e mallrave përkatësisht • *Mufte TU 0,4 KV për kabëll 4 x 25-150 mm²*; • *Mufte TM për kabëll të thatë 24 KV 1 x (95-240) mm²*; • *Kabëll TU, AL 4 x 95 mm², XLPE, 0.6/1kV*; • *Kabell TM 10 kV, XLPE, Al – 3 x 95mm²*;, në momentin e hapjes së ofertave pranë Autoritetit Kontraktor Drejtorise Rajonale Fier OSSH sh.a., Komisioni konstaton, se nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që ofertuesit pjesmarrës në procedurë të paraqesin mostrat ditën e hapjes së ofertave pranë autoritetit kontraktor vetëm për artikuj e sipërcituar. Së pari, referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik nuk konstaton, që operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin mostra edhe për produktin Gilzë të parashikuar në shtojcën 6 “Formulari sasisë dhe grafikut të ekzekutimit”, pasi referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit pikës 2.2.7 nuk është përcaktuar që për produktin gilzë operatorët ekonomik duhet të paraqesin mostër pranë autoritetit kontraktor ditën e hapjes së ofertave ashtu sikursë është kërkuar për 4 (katër) produktet e tjera. Pra, nga ana e autoritetit kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit nuk është kërkuar në asnjë rast që ofertuesit duke paraqesin mostër edhe për produktin gilzë. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Aci Engineering*” SHPK mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomik ofertues “*Clover*” SHPK & “*Vuho 2018*” SHPK është bërë duke iu referuar një një kriteri kualifikues të pakërkuar, çka nuk është në përputhje me ligjin për prokurimin publik dhe përsa kohë produkti gilzë nuk ka qënë objekt i paraqitjes si mostër pranë autoritetit kontraktor KPP nuk mund të gjykojë mbi këtë produktë në lidhje me përputhshmërinë e tij me specifikimet teknike.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Aci Engineering” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorit ekonomik “Clover” SHPK & “Vuho” SHPK me arsyet: “Në DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.2.2.3 Kërkohej: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për mallrat objekt prokurimi të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vertetojnë pajtueshmërinë e mallrave të prodhuara (lista e mësipërme të mallrave) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Shoqëria “Clover” Shpk nuk ka paraqitur dëshmi të testimeve zyrtare (Test Raportet) për artikujt nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 tek lista e mallrave . Për këtë arsye kërkojmë që oferta e operatorit ekonomik “Clover” shpk”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.2. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2.3 “Kapaciteti Teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për mallrat objekt prokurimi të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vertetojnë pajtueshmërinë e mallrave të prodhuara (lista e mësipërme të mallrave) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.*

III.2.3. Në shtojcën 6 “Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Artikulli	Përshkrimi	Njesia	(Sasia)	Periudha e dorëzimit
	MUFTE, KOKA KABLLI TU dhe TM			
1	Mufte TU 0,4 KV per kabell 4x25-95 mm ²	set	450	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
2	Mufte TU 0,4 KV per kabell 4x25-150 mm ²	set	450	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
3	Mufte TM per kabell te thate 12KV 3 x(70-150) mm ²	set	50	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
4	Mufte TM per kabell te thate 24 KV 1x(25-70) mm ²	set	300	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
5	Mufte TM per kabell te thate 24 KV 1x(95-240) mm ²	set	2500	90 dite nga

				nenshkrimi i kontrates
6	Gliza me bullon per kabell XLPE - AL 185 mm ² 24 kv	cope	300	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
7	Mufte TM per kabell me vaj 24 kV 1x(150-240) mm ²	set	10	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
8	Mufte TM kalimtare nga kabell I thate XLPE ne kabell me vaj 24 kV 1x (150-240)mm ²	set	20	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
9	Koka kablli TM 10kV, te brendshme 3x(25-95)mm ²	set	250	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
10	Koka kablli TM 10kV, te brendshme 3x(95-240)mm ²	set	60	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
11	Koka kablli TM 20kV, te brendshme 1x(95-240)mm ²	cope	1200	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
12	Koka kablli TM 10kV, te jashtme 1x(25-95)mm ²	set	150	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
13	Koka kablli TM 10kV, te jashtme 3x(25-95)mm ²	set	40	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
14	Koka kablli TM 20kV, te jashtme 1x(95-240)mm ²	cope	400	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
Kablllo fuqie TU dhe TM				
15	Kabell TU, AL 4x50 mm ² , XLPE, 0.6/1kV	ml	6000	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
16	Kabell TU, AL 4x70 mm ² , XLPE, 0.6/1kV	ml	7000	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
17	Kabell TU, AL 4x 95 mm ² , XLPE, 0.6/1kV	ml	8000	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
18	Kabell TU, AL 3x 120+70 mm ² ,XLPE, 0.6/1kV	ml	5000	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
19	Kabell TM 10 kV, XLPE, Al - 3x 70mm ²	ml	600	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
20	Kabell TM 10 kV, XLPE, Al - 3x 95mm ²	ml	2000	90 dite nga

				nenshkrimi i kontrates
21	Kabell TM 10 kV, XLPE, Al - 3x 120mm ²	ml	1000	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
22	Kabell TM 20 kV, XLPE, gershet Al 3x(1x185)mm ²	ml	550	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
23	Kabell TM 20 kV, XLPE, gershet Al 3x(1x240)mm ²	ml	1550	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
24	Kabell TM 20 kV, XLPE, Al - 1x 70mm ²	ml	700	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
25	Kabell TM 20 kV, XLPE, Al - 1x 1850mm ²	ml	1050	90 dite nga nenshkrimi i kontrates
26	Kabell TM 20 kV, XLPE, Al - 1x 240mm ²	ml	2000	90 dite nga nenshkrimi i kontrates

III.2.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se bashkimi i operatorit ekonomike “Clover” SHPK & “Vuho 2018” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- 1- Shtojca 5 “Formulari i specifikimeve teknike”;
- Deklaratë nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK mbi origjinën dhe prodhuesin për artikujt e ofruar për këtë procedurë prokurimi;
- Shtojca 2 “Lista e çmimeve”, ku pasqyrohet nr i artikullit, përshkrimi i mallit, sasia, çmimi për njësi, çmimi total për artikull dhe afati;
- Letër autorizimi Distributori Zyrtar i Elcon Megarad S.P.A, ITALI, akese per kabuj fuqie...”, lëshuar për Santi Partners;
- Autorizim distributori Santi Partners per Clover shpk date 09.08.2022;
- Test raporte Elcon Megarad;
- Test raporte te tjera Elcon Megarad;
- Prospet Katalogu Elcon Megarad (i përkthyer dhe i noterizuar);
- Skeda teknike e fabrikes Elcon Megarad
- Skede teknike te vulosur nga distributori

III.2.5. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit

publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.6. Në nenin 3 Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.7. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.2.8. Në nenin 40 pika 1, 2 dhe 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.

2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

3. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i

kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.2.9. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose

shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor”

III.2.10 . Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.2.11. KPP-ja gjykon se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.2.12. Në përputhje me nenin 24 pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në marrjen e vendimeve mban parasysht, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit.”*

Komisioni, në jurisprudencën e tij, e ka bërë pjesë të standardeve për një proces të rregullt ligjor edhe respektimin e parimit të kontradiktoritetit. Për sa më sipër, parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin administrativ, është një evolucion logjik i të drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t’u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi, për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në shqyrtimin administrativ, atëherë argumentet e njëjës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues, dhe ligjor për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Ndaj për këtë qëllim, Komisioni organizoi një seancë dëgjimore mes palëve në lidhje me evidentimin e test rraporteve të paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Clover” SHPK & “Vuho 2018” SHPK për artikujt 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 të shtojcës 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”.

III.2.13. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, KPP vëren se, autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, në shtojcën 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”, ka përcaktuar artikujt për të cilët duhet të paraqiten dhe test rraportet nga prodhuesi ose institucione të autorizuara në mënyrë që të evidentohet pajtueshmëria e këtyre mallrave me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Gjithashtu, në “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2.3 e “Kapacitetit teknik”, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që *operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmi të testimeve zyrtare të kryera për mallrat objekt prokurimi të leshuara nga institucione të autorizuara ose nga prodhuesi, që vertetojnë pajtueshmërinë e mallrave të prodhuara (lista e mësipërme e mallrave) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.*

KPP konstaton se, qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet test rraporteve të kërkuar, të verifikohen specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë, për të parë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për këto artikuj.

III.2.14. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorit ekonomikë “Clover” SHPK & “Vuho 2018” SHPK, konstaton se, ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur në SPE - **1- Shtojca 5 “Formulari i specifikimeve teknike”;** **2- Deklaratë nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK mbi origjinën dhe prodhuesin për artikujt e ofruar për këtë procedurë prokurimi;** **3- Shtojca 2 “Lista e çmimeve”, ku pasqyrohet nr i artikullit, përshkrimi i mallit, sasia, çmimi për njësi, çmimi total për artikull dhe afati;** **4- Letër autorizimi Distributori Zyrtar i Elcon Megarad S.P.A, ITALI, akesore per kabuj fuqie...”, lëshuar për Santi Partners;** **5- Autorizim distributori Santi Partners per Clover shpk date 09.08.2022;** **6-Test raporte Elcon Megarad;** **7- Test raporte te tjera Elcon Megarad;** **8- Prospet Katalogu Elcon Megarad (i përkthyer dhe i noterizuar);** **9- Skeda teknike e fabrikes Elcon Megarad;** **10- Skede teknike te vulosur nga distributori.**

Në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke qenë se KPP shfaqti vështirësi në evidentimin dhe verifikimin e test rraporteve për të cilat operatori ekonomik ankimues “Aci Engineering” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga bashkimi i operatorit ekonomikë “Clover” SHPK & “Vuho 2018” SHPK, për disa nga artikujt konkretisht 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, nuk janë paraqitur test rraportet dhe dokumentacioni i paraqitur nga ky i fundit në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), KPP me anë të shkresë nr. 1951/7 prot., datë 21.10.2022 i kërkoi bashimit të operatorit ekonomik “Clover” SHPK & “Vuho 2018” SHPK, me qëllim gjykimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, të dorëzojë pranë KPP-së informacionin dhe faktet se në cilin test rraport apo dokument (faqe, paragraf etj.), nga ato të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, gjenden artikujt 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 për të cilat ngren pretendime operatori ekonomik ankimues se nga ana juaj nuk janë paraqitur test rraportet.

Me anë të shkresë të protokolluar me tonën me shkresën nr. 594/1 prot, datë 27.10.2022, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1951/8 prot, datë 31.10.2022 autoriteti kontraktor ka dërguar informacion pranë Komisionit Prokurimit Publik, në lidhje me objektin e kërkesës nr. 1951/7 prot, datë 21.10.2022.

III.2.15. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, dokumentacioni i dorëzuar në SPE nga bashkimi i operatorit ekonomik “Clover” SHPK & “Vuho 2018” SHPK, si dhe sqarimet e autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë KPP-së, konstatohet se bashkimi i operatorit ekonomik “Clover” SHPK & “Vuho 2018” SHPK ka paraqitur test rraportet **Test raporte Elcon Megarad; Test raporte te tjera Elcon Megarad**, në të cilin pasqyrohen artikujt 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 për të cilat ngren pretendime operatori ekonomik ankimues se nuk janë paraqitur test rraportet për këto artikuj me kodet përkatëse.

Për shkak të specifikës së kësaj procedurë prokurimi dhe vështirësisë në evidentimin e artikujve 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 në test rraportet e dorëzuar në SPE sistemin e prokurimeve elektronike nga bashkimi i operatorit ekonomik “Clover” SHPK & “Vuho 2018” SHPK, KPP në datën 25.11.2022, ora 11:00 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, zhvilloi një Seancë Dëgjimore midis përfaqësuesit të bashkimit të operatorit ekonomikë “Clover” SHPK & “Vuho 2018” SHPK z. A. M, dhe përfaqësuesit të autoritetit

kontraktor z. A. N, dhe anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, përfaqësuesve të palëve pjesëmarrëse nga ana e KPP ju shtruan pyetjet për artikujt për të cilat KPP nuk arriti ti evidentonte në test rraportet e paraqitura në SPE nga operatori ekonomik konkretisht: **1. Ju lutem sqaroni se ne cilin test raport te paraqitur ne SPE gjenden te pershkruar artikulli nr 1 Mufte TU 0,4 KV per kabell 4x25-95 mm2 dhe artikulli nr. 2 Mufte TU 0,4 KV per kabell 4x25-150 mm2.** Nga ana e përfaqësuesit te OE u citua se ky artikull gjendet ne test raportin nr C0001314 konkretisht ne faqen 3 gjenden test raportet e këtyre artikujve dhe konkretisht tek pershkrimi ato identifikohen me kodet FN 19854 dhe FN 19890, edhe perfaqesuesi i autoritetit kontraktor pohoi se artikujt e mesiperme perfaqesohen me test raportin numer C0001314, faqe numer 1 deri ne faqen numer 6 te dokumentit te ngarkuar elektornikisht ne sistemin e APP-se te emertuar “test raporte elcon megarad.pdf”; të dy palët në lidhje me specifiken per kabell 4x25-95 mm2, ata u shprehen se ne kete kode produkti yne eshte i permbushr me 2x25/ 16 2x25 pra ky product ka ne perberje te tij 4 fije me seksion 25 mmm , ndersa ne lidhje me dimesionin e seksionit ata citojne se teste raportet e dorzuara nga ana jone e perfshin dhe seksionin e kerkuar nga AK pasi jane per nje seksion me te madh; **2. Ju lutem sqaroni se ne cilin test raport te paraqitur ne SPE gjenden te pershkruar artikulli nr 3 Mufte TM per kabell te thate 12KV 3 x(70-150) mm2.** Nga ana e përfaqësuesit te OE u citua se ky artikull gjendet ne test raportin nr 447_15 konkretisht ne faqen 2 gjendet test raporti i këtij artikulli dhe konkretisht tek pershkrimi ai identifikohet nga kodi mr nr rendor 3 deri ne kodin me nr rendor 6 te faqes 2 ne te cilat identifikohet numri i dejeve 3, edhe perfaqesuesi i autoritetit kontraktor pohoi se artikulli i mesiperme perfaqesohen me test raportin numer 447_15, faqe numer 48 deri ne faqen numer 69 te dokumentit te ngarkuar elektornikisht ne sistemin e APP-se te emertuar “test raporte te tjera elcon megarad.pdf”; të dy palët në lidhje me specifiken per kabell 12 kv 3x70-150 mm2, ata u shprehen se test raporti kryhet per nje pjese te kabullit pasi si kabulli me tre deje ashtu dhe ai me nje deje i njejti testim i kryhet gjithashtu dhe perberja e tyre eshte e njejte thjeshte ndryshon sasia e kabullit, ndersa ne lidhje me dimesionin e seksionit ata citojne se teste raportet e dorzuara nga ana jone e perfshin dhe seksionin e kerkuar nga AK pasi jane per nje seksion me te madh; **3. Ju lutem sqaroni se ne cilin test raport te paraqitur ne SPE gjenden te pershkruar artikulli nr 4 Mufte TM per kabell te thate 24 KV 1x(25-70) mm2.** Nga ana e përfaqësuesit te OE u citua se ky artikull gjendet ne test raportin nr TT36_21 konkretisht ne faqen 2 gjendet test raporti i këtij artikulli dhe konkretisht tek pershkrimi ai identifikohet me kodin ELCOTERM GLC-2463 E U/U tension 15/8,7 kv, seksion 3x50 mm Cu / 3x70 mm Al edhe perfaqesuesi i autoritetit kontraktor pohoi se artikulli i mesiperme perfaqesohen me test raportin numer TT36 21 , faqe numer 68 deri ne faqen numer 73 te dokumentit te ngarkuar elektronikisht ne sistemin e APP-se te emertuar “test raporte elcon megarad.pdf”; të dy palët në lidhje me specifiken per kabell 24 KV 1x(25-70) mm2, ata u shprehen se test raporti ne lidhje me dimesionin e seksionit ata citojne se teste raportet e dorzuara nga ana jone e perfshin dhe seksionin e kerkuar nga AK pasi jane per nje seksion me te madh. Ne lidhje me tensionin e kerkuar 24 kv dhe ne test raport percaktohet 15/8,7 kv, shprehen se test raporti yne eshte kryer me tension me te larte nga 34.8 deri 110 kv; **4. Ju lutem sqaroni se ne cilin test raport te paraqitur ne SPE gjenden te pershkruar artikulli nr 5 Mufte TM per kabell te thate 24 KV 1x(95-240) mm2.** Nga ana e përfaqësuesit te OE u citua se ky artikull gjendet ne test raportin nr 438A_14 konkretisht ne faqen 2 gjendet test raporti i këtij artikulli dhe

konkretisht tek pershkrimi ai identifikohet me kodin ELCOTERM GLS-4285/ALë-R tension 20.8, / 36 kv, seksion 1x240 sqmm AL/XLPE/PVC IEC 60502-4 edhe perfaqesuesi i autoritetit kontraktor pohoi se artikulli i mesiperme perfaqesohen me test raportin numer 438A_14, faqe numer 26 deri ne faqen numer 35 te dokumentit te ngarkuar elektornikisht ne sistemin e APP-se te emertuar "test raporte te tjera elcon megarad.pdf"; të dy palët në lidhje me specifikën per kabell 24 KV 1x(95-240) mm², ata u shprehen se test raporti ne lidhje me dimesionin e seksionit ata citojne se teste raportet e dorzuara nga ana jone e perfshin dhe seksionin e kerkuar nga AK pasi jane per nje seksion me te madh. Ne lidhje me tensionin e kerkuar 24 kv dhe ne test raport percaktohet 20.8/36 kv, shprehen se test raporti yne eshte kryer me tension me te larte max 42 kv; **5. Ju lutem sqaroni se ne cilin test raport te paraqitur ne SPE gjenden te pershkruar artikulli nr 7 Muftje TM per kabell me vaj 24 kV 1x(150-240) mm².** Nga ana e përfaqesuesit te OE u citua se ky artikull gjendet ne test raportin nr 447_15 konkretisht ne faqen 2 gjendet test raporti i këtij artikulli dhe konkretisht tek pershkrimi ai identifikohet me kodin ECOLD GLS 3689 1x120 ÷240 sqmm Cu/Al, perfaqesuesi i autoritetit kontraktor pohoi se artikulli i mesiperme perfaqesohen me test raportin numer 477_15, faqe numer 48 deri ne faqen numer 69 te dokumentit te ngarkuar elektronikisht ne sistemin e APP-se te emertuar "test raporte te tjera elcon megarad.pdf"; të dy palët në lidhje me specifikën per kabell 24 kV 1x(150-240) mm², ata u shprehen se test raporti ne lidhje me dimesionin e seksionit ata citojne se teste raportet e dorzuara nga ana jone e perfshin dhe seksionin e kerkuar nga AK pasi jane per nje seksion me diapazon nga 120 – 240, i cili perfshin dhe 150 si seksion. me te madh. Ne lidhje me tensionin e kerkuar 24 kv dhe ne test raport percaktohet 24 -36 kv, shprehen se test raporti yne eshte kryer me tension me te larte duke perfshire dhe 24 kv e kerkuar; **6. Ju lutem sqaroni se ne cilin test raport te paraqitur ne SPE gjenden te pershkruar artikulli nr 8 Muftje TM kalimtare nga kabell I thate XLPE ne kabell me vaj 24 kV 1x (150-240) mm².** Nga ana e përfaqesuesit te OE u citua se ky artikull gjendet ne test raportin nr 4748 / VNL konkretisht ne faqen 3 gjendet test raporti i këtij artikulli dhe konkretisht tek pershkrimi ai identifikohet me kodin ELCOTERM GLM 2463/EN konkretisht muftje kalimtare 12.7/22 (24) kv 95-240 mm², perfaqesuesi i autoritetit kontraktor pohoi se artikulli i mesiperme perfaqesohen me test raportin numer 4748/VNL , faqe numer 37 deri ne faqen numer 52 te dokumentit te ngarkuar elektomikisht ne sistemin e APP-se te emertuar "test raporte elcon megarad.pdf"; të dy palët në lidhje me specifikën per kabell 24 kV 1x(150-240) mm², ata u shprehen se test raporti ne lidhje me dimesionin e seksionit ata citojne se teste raportet e dorzuara nga ana jone e perfshin dhe seksionin e kerkuar nga AK pasi jane per nje seksion me diapazon nga 95 – 240, i cili perfshin dhe 150 si seksion me te madh. Ne lidhje me tensionin e kerkuar 24 kv dhe ne test raport percaktohet nga 12-24 kv, shprehen se test raporti yne eshte kryer me tension me te vogel por deri ne 24 kv sic eshte kerkuar; **7. Ju lutem sqaroni se ne cilin test raport te paraqitur ne SPE gjenden te pershkruar artikulli nr 9 Koka kablli TM 10kV, te brendshme 3x(25-95) mm².** Nga ana e përfaqesuesit te OE u citua se ky artikull gjendet ne test raportin nr 447_15 konkretisht ne faqen 2 gjendet test raporti i këtij artikulli dhe konkretisht tek pershkrimi ai identifikohet me kodin ECOLD TES 2464 P 3x1x95 ÷240 sq. mm Cu/Al, perfaqesuesi i autoritetit kontraktor pohoi se artikulli i mesiperme perfaqesohen me test raportin numer 477 15, faqe numer 48 deri ne faqen numer 69 te dokumentit te ngarkuar elektornikisht ne sistemin e APP-se te emertuar "test raporte te tjera elcon megarad.pdf"; të dy palët në lidhje me specifikën per

*Koke kablli TM 10kV, te brendshme 3x(25-95)mm2, ata u shprehen se test raporti ne lidhje me dimesionin e seksionit ata citojne se teste raportet e dorzuara nga ana jone e perfshin dhe seksionin e kerkuar nga AK ato fillojne ne test raport nga seksioni 50 mm deri ne 240 mm pra perfshin dhe seksionin e kerkuar nga AK,. Ne lidhje me tensionin e kerkuar 10 kv dhe ne test raport percaktohet nga 12-24 kv, shprehen se test raporti yne eshte kryer me tension me madhe sec eshte kerkuar duke perfshire dhe tensionin e kerkuar; **8. Ju lutem sqaroni se ne cilin test raport te paraqitur ne SPE gjenden te pershkruar artikulli nr 10 Koka kablli TM 10kV, te brendshme 3x(95-240) mm2.** Nga ana e përfaqesuesit te OE u citua se ky artikull gjendet ne test raportin nr 439_15 konkretisht ne faqen 2 dhe 3 gjendet test raporti i këtij artikulli dhe konkretisht tek pershkrimi ai identifikohet me kodin ELCOTERM TIS- 1282X/Eë 1x95÷240mm2 Cu/Al, perfaqesuesi i autoritetit kontraktor pohoi se artikulli i mesiperme perfaqesohen me test raportin numer 439_15, faqe numer 36 deri ne faqen numer 47 te dokumentit te ngarkuar elektornikisht ne sistemin e APP-se te emertuar “test raporte te tjera elcon megarad.pdf”; të dy palët në lidhje me specifikën per Koke kablli TM 10kV, te brendshme 3x(95-240)mm2, ata u shprehen se test raporti ne lidhje me dimesionin e seksionit ata citojne se teste raportet e dorzuara nga ana jone e perfshin dhe seksionin e kerkuar nga AK. Ne lidhje me tensionin e kerkuar 10 kv dhe ne test raport percaktohet nga 6-10-12 kv, shprehen se test raporti yne eshte kryer me tension me madhe sec eshte kerkuar duke perfshire dhe tensionin e kerkuar.*

Sa më sipër, KPP nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, verifikimi i test rraporteve të dorëzuar në SPE nga bashkimi i operatorit ekonomikë “Clover” SHPK & “Vuho 2018” SHPK sqarimeve dhe argumentave të dorëzuara nga autoriteti kontraktor pranë KPP, si dhe deklarimeve të përfaqësuesve në seancën degjimore të mbajtur në datë 25.11.2022, KPP gjykon se, bashkimi i operatori ekonomik “Clover” SHPK & “Vuho 2018”, ka paraqitur test rraporte për të gjithë artikujt për të cilat operatori ekonomik ankimues ngren pretendime. Koncretisht, vetë specialisti i autoritetit kontraktor dhe përfaqësuesi i bashkimit të operatorit ekonomik “Clover” SHPK & “Vuho 2018” SHPK deklarojnë në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik ka paraqitur test rraporte për të gjithë artikujt për disa nga artikujt ata shprehen se test raportet e paraqitura edhe pse nuk janë paraqitur për dimensionet fikse dhe tension e kërkuar nga autoriteti kontraktor në shtojcën 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të ekzekutimit” në lidhje me dimesionin e seksionit ata citojnë se teste rraportet e dorëzuara nga ana jonë, janë me dimensione më të mëdha por të cilat e përfshin dhe seksionin e kërkuar nga AK, edhe në lidhje me tensionin e kerkuar në test raport e paraqitura shprehen se testi yne për produktet eshte kryer nën një tension më të madhe sec është kërkuar nga AK cka vërteton rezistueshmërinë e produktit duke perfshire dhe tensionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në këtë mënyrë, KPP referuar pretendimit të ankimuesit, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi operatorit ekonomikë “Clover” SHPK & “Vuho 2018” SHPK, dhe ballafaqimit në ceancën degjimore të datës 25.11.2022 konstaton se bashkimi operatorit ekonomikë “Clover” SHPK & “Vuho 2018” SHPK ka paraqitur test rraportet për secilin nga artikujt 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, ndaj nga sa më sipër argumentuar, gjykojmë se bashkimi i operatorit ekonomikë “Clover” SHPK & “Vuho 2018” SHPK me anë të dokumentacionit të paraqitur vërteton se janë paraqitur test rraportet respektive të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Aci Engineering” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-33139-06-16-2022, me objekt “Blerje kablllo fuqie TM/TU dhe aksesore ndihmës”, me fond limit 149,936,016 lekë pa TVSH, ose 1,251,030 euro pa TVSH sipas kursit të datës 16.06.2022 të Bankës Shqiptare, zhvilluar në datën 12.08.2022 nga autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH Fier.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Aci Engineering” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

